



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2260 prot.

Himarë, më 02.05. 2024

V E N D I M

Nr. 13, datë 26.04.2024

“PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE LIGJORE ,CIVILE, PENALE PËR ZGJIDHJEN GJYQËSISHT TË MARRËVESHJES NR.3252, DATË 13.07.2023 TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË ,LIDHUR MIDIS BASHKISË HIMARË,BASHKISË VLORË ,BASHKISË SELENICË ,ME OBJEKT, “MARRËVESHJE PËR KRIJIMIN E SUBJEKTIT TË KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA TË UJËSJELLËS - KANALIZIMEVE”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, gërma “b”, dhe nenit 54, pika “e”, “ë”, “h”, “k” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, dhe VKB – së nr.33, datë 28.07.2023 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Himarë”, Këshilli Bashkiak me 14(katërmbëdhjetë) vota pro,një kundër ,0 abstenim pasi shqyrtoi kërkesën e këshilltarëve të grupit të Koalicionit BF e miratoi dhe si më poshtë vijon,

V E N D O S I :

1. Fillimin e procedurave ligjore ,civile ,penale për zgjidhjen gjyqësisht të marrëveshjes nr.3252,datë 13.07.2023 ku ligji e thotë “këshilli ,grupi i këshilltarëve ,çdo këshilltar ka të drejtën për ta ndjekur ligjërisht”.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Bashkia Himarë
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT

Dhimitër Kapaj

